

Ligji 38/2023 date 08.06.2023
PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008,
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 9, pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Subjektet e përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, si dhe subjektet e prodhimit të produkteve ushqimore të ambalazuara, të cilat kanë në përbërje të tyre qumësht pluhur të klasifikuar në kodet 0402 10 19 dhe 0402 21 18 të NKM-së, hirrë qumështi të klasifikuar në kreun 0404 10 të NKM-së dhe krem qumështi të klasifikuar në kreun 0402 të NKM-së, përjashtohen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hirrë qumështi dhe taksës për krem qumështi vetëm për sasinë e importuar, për qëllim prodhimi, në përputhje me etiketën e produktit të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ku evidentohet sasia në përqindje të këtyre produkteve, që janë trupëzuar në produktin përfundimtar.

Në rast të përdorimit të qumështit pluhur, hirrës së qumështit dhe krem qumështit, jo për qëllimet e veta dhe me destinacion të ndryshëm nga ai për të cilin përfitohet përjashtimi sipas kësaj pike, subjektet e përpunimit dhe prodhimit të këtyre produkteve detyrohen të paguajnë të gjithë vlerën e taksës për të cilën kanë përfituar përjashtimin. Për qëllime të zbatimit të kësaj pike, autoritetet tatimore kryejnë kontrole periodike. Kriteret, kushtet dhe procedurat e përjashtimit, si dhe periodiciteti i kontrollit, sipas kësaj pike, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për kontrollin ushqimor.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.6.2023.

Shpallur me dekretin nr. 86, datë 23.6.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

Botuar ne F.Zyrtare 95/2023

Dale nga shtypi me 27.06.2023